



ANALIZA E PËRPUTHSHMËRISË SË KUADRIT LIGJOR TË SHQIPËRISË ME KONVENTËN E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA AKSESUESHMËRIA DHE PJESËMARRJA NË JETËN PUBLIKE DHE POLITIKE



Botim i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
RR. "Bogdanëve", Nr19, Tiranë
Tel/Fax:+3554269426
www.adrf.al;
E-mail: info@adrf.al;

Disa nga figurat e këtij materiali janë prodhuar nga "Inspired Services Publishing Ltd"
Ky raport u përgatit me mbështetjen e projektit rajonal "SMART Balkans – Shoqëria civile për vlera të përbashkëta në Ballkanin Perëndimor" të zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD), Qendra për Kërkim dhe Krijim Politikash (CRPM) dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA).
Përmbajtja e është përgjegjësi vetëm e zbatuesve të projektit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA)



Ky është versioni i shkurtër i raportit.

Një raport më i gjatë është përgatitur për të njëjtin qëllim.



Të dhënat janë mbledhur përmes edhe diskutimeve me PAK dhe takimet me grupin e punës.



PAK- persona me aftësi të kufizuara



Raporti përmban analizën e përmbledhur të Kornizës Ligjore të Shqipërisë dhe rekomandimet e nevojshme për ndërhyrje.



Një raport i ngjashëm është realizuar edhe në Maqedoninë e Veriut dhe në Kosovë.

Raportet kanë për qëllim, avokimin në nivel kombëtar edhe rajonal për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.



Qëllimi i raportit është të tregojë:

- (i) Sa Shqipëria ka rregulluar me ligj të drejtat e personave me aftësi të kufizuara;
- (ii) Aktet ligjore me fokus aksesueshmërinë dhe pjesëmarrjen në jetën publike dhe politike, në krahasim me Konventën;
- (iii) Cilat janë institucionet që kujdesen për zbatimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri.



Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, ka hyrë në fuqi nga viti 2008.

E kanë: ratifikuar 186 shtete/164 nënshkruar. Protokolli i saj, është ratifikuar nga: 104 shtete / 94 nënshkruar.



Konventa, është dokument i detyrueshëm ndërkombëtar për shtetet, të cilat e kanë pranuar dhe ratifikuar atë.



Konventa ka për qëllim të sigurojë që shtetet të respektojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.



Konventa kërkon që shtetet të harmonizojnë ligjet e tyre me Konventën.


Konventa është e zbatueshme në Shqipëri dhe ka epërsi ndaj ligjeve të Shqipërisë.



Kushtetuta e Shqipërisë, siguron trajtim të barabartë dhe respektim të të drejtave të njeriut për të gjithë njësoj.



Shqipëria, e ka adresuar aftësinë e kufizuar në legjislacionin e saj.



Ligjet për aftësinë e kufizuar i kanë trajtuar personat me aftësi të kufizuar sipas llojeve të aftësisë së kufizuar.

P.sh. Ka ligje që mbështesin financiarisht personat e verbër, personat paraplegjik dhe tetraplegjik, invalidët e punës.



Ka edhe ligje tjera që rregullojnë çështje të ndryshme në shoqëri e që kanë dispozita për aftësinë e kufizuar.



Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi e ka njohur aftësinë e kufizuar si bazë për diskriminim.

PAK mund të ngrenë padi, nëse besojnë se janë duke u diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar.



Për këtë raport janë analizuar vetëm ligjet që kanë përfshirë aksesueshmërinë dhe pjesëmarrjen në jetën publike dhe politike.



Në Konventë, aksesueshmëria është në nenin 9 dhe pjesëmarrja në jetën publike dhe politike në nenin 29.



Ka disa Komitete në kuadër të Konventës të cilët japin rekomandime se si të zbatohen nenet e Konventës.

Komitetet e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, janë mekanizma të Konventës.



Në këtë raport janë përfshirë disa rekomandime të Komiteteve për aksesueshmërinë dhe pjesëmarrjen.

Të gjitha rekomandimet janë të rëndësishme.



Fjalët kyçe për aksesueshmërinë janë:

- jetesa e pavarur
- pjesëmarrja efektive në shoqëri.




Fjalët kyçe për pjesëmarrjen janë:

- pjesëmarrja në votime dhe zgjedhje
- përfaqësimi në institucione publike.



Të gjitha këto vlejné për:

- institucionet publike dhe private që janë në shërbim të publikut
- duhet të aplikohen për zonat urbane dhe rurale.



Të gjitha këto që garanton Konventa dhe Komitetet, janë analizuar nëse janë në:

- legjislacionin e Shqipërisë, dhe
- nëse legjislacioni i Shqipërisë është i ngjashëm me Konventën.



Është konstatuar që ligjet në Shqipëri nuk janë në harmoni të plotë me Konventën, sa i përket aksesueshmërisë dhe pjesëmarrjes.



Kur flasim për aksesueshmërinë, jemi duke menduar për:

- Mjedisin fizik
- Transportin publik
- Informimin dhe Komunikimin, TIK
- Shërbimet Publike



Mjedisi fizik janë:

Rrugët, trotuaret, qendra e qytetit, hapësirat publike, parqet, institucionet publike, shëndetësore, spitalet, rekreacioni, shkollat, edukative, kulturore, turistike, parkingjet, hyrjet në ndërtesa.



Ka disa ligje që i adresojnë disa nga këto, por jo në mënyrë të plotë.



Transporti publik përfshin:

- autobusët, aeroplanët, anijet, taksi, furgoni;
- stacione, stacione autobusi, aeroporte, rrugë, ura, vendkalime për këmbësorë, trotuaret;
- tabelat në stacionet e autobusëve, oraret, hartat, informacionet për udhëtarët në aeroporte;
- informacione të aksesueshme brenda trenave, autobusëve, etj.;
- për ndalesat aktuale dhe të ardhshme, procedurat e urgjencës, si të telefononi për ndihmë;
- platforma dixhitale që ofrojnë në kohë reale informacion mbi sistemin e transportit;
- shërbimet e internetit për të rezervuar një biletë ose procedurat për ankesë.



Disa nga këto çështje mungojnë në ligje.



Komunikimi dhe informimi i referohet:

- Informacionit, komunikimit dhe shërbimeve të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe ato të urgjencës, por nuk kufizohet vetëm në këto.
- Përfshin ndër të tjerat edhe teknologjinë e informacionet dhe komunikimit (TIK), si arritje moderne e zhvillimet aktuale.

Disa çështje i gjejmë në ligje, por janë të shpërndara, ka disa çështje që nuk janë fare në ligje.



Në shërbime publike hyjnë, por nuk kufizohen;

- kujdesi shëndetësor
- edukimi/arsimi
- energjia
- shërbimet ligjore
- telekomunikacioni
- shërbimet e transportit dhe infrastrukturës së transportit
- planifikimi urban
- shërbimet e emergjencës
- furnizimi me ujë
- mbrojtja e ambientit
- shërbimet sanitare
- shërbimet postare
- shërbimet e rekreacionit
- programet ekonomike dhe të agrikulturës shërbimet sociale
- ndërtesat publike.





PAK janë përfshirë në disa ligje për fushat më sipër. Në disa prej tyre, përfshirja nuk është e plotë. Në disa të tjera mungon.



Legjislacioni nuk e adreson në tërësi fushën e aksesueshmërisë.

Ka komponentë që nuk adresohen fare në legjislacion.

Disa herë dispozitat ligjore janë të shpërndara në ligje të ndryshme.



Disa janë të fragmentuara që d.m.th. një çështje adresohet në 2 ose më shumë vende.

Disa janë të pa plota, që d.m.th. diçka rregullojnë e diçka jo.



Kur flasim për pjesëmarrjen jemi duke folur për:

- daljen në votime
- të qenët kandidatë në zgjedhje
- të bërit fushatë publike
- të përfshirët në poste publike
- të marrët pjesë në OJF
- të krijuarit e një OJF
- të marrët pjesë në takime të ndryshme si në vend, në rajon ose kudo në botë.



Ligji për zgjedhje e ka trajtuar deri diku mirë votimin e personave me aftësi të kufizuara.



Edhe pse në realitet ka barriera fizike, informacioni dhe komunikimi për të marrë pjesë në votime.

Nuk ka kriter për partitë politike që të përfshijnë PAK në lista zgjedhore.



Përfaqësimi në institucione publike është shumë i ulët, edhe pse ligji nuk e ndalon.



Njëloj është edhe pjesëmarrja në takime në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.

Formimi i OJF-ve dhe pjesëmarrja është e rregulluar me ligj, njëloj si për organizatat tjera.



Përfundimisht, marrja pjesë në votime, është e rregulluar në ligj. Edhe Kushtetuta e ka rregulluar atë.

Për komponentët e tjera të pjesëmarrjes, ka nevojë për harmonizim.



Nuk ka ndonjë institucione të veçantë, për të monitoruar a po respektohen të drejtat e PAK.

Edhe pse secili ligj e ka përcaktuar se kush është përgjegjës për zbatimin e tij.



Në Shqipëri, për aftësinë e kufizuar, ka një Këshill Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar në nivel qendror dhe pikat fokale në nivel lokal.



Në këtë raport gjithashtu është një formë e përmbledhur e Analizës së Kornizës Ligjore të Shqipërisë për aksesueshmërinë dhe pjesëmarrjen.

Janë dhënë rekomandime për ndryshime, plotësime dhe hartim legjislacioni të ri për këto dy çështje.



Në këtë stad, për aftësinë e kufizuar, rekomandojmë që:

- Institucionet e Shqipërisë në afat sa më të shkurtër të bëjnë rishikim strukturor të kornizës legjislative dhe institucionale;
- Të harmonizojnë atë me standardet e kërkuara të Konventës,
- Adresimi i politikave të aksesueshmërisë, si parakushte për pjesëmarrje efektive në jetën publike dhe realizimin e të drejtave për PAK.



Kujt do ti shërbejë raporti ?

Raporti, do t'u shërbejë institucioneve të Shqipërisë:

- si udhërrëfyes për adresimin e plotë të çështjeve të aftësisë së kufizuar në hartimin e politikave dhe legjislacionit adekuat sepse, ka boshllëqe ligjore në këto çështje në përgjithësi dhe posaçërisht në fushat e targetuara në këtë analizë.



Raporti, do t'u shërbejë organizatave të personave me aftësi të kufizuar dhe personave me aftësi të kufizuar:

- të avokojnë tek institucionet publike në nivel kombëtar dhe lokal, përfshirë ato ligjvënëse dhe të administratës për adresimin e çështjeve të rëndësishme, në mënyrë që kjo pjesë e shoqërisë të mund të gëzojë të drejtat e garantuara.



Ky raport dhe raportet tjera, duhet të përdoret për të adresuar çështjet e aftësisë së kufizuar.



Harmonizimi i infrastrukturës ligjore të Shqipërisë duhet të garantojë një përputhshmëri me standardet e kuadrit të Konventës.

